



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/25 Nr. i faq/Br.str/No.pg 70

Data/Datum/Data 24 / 09 / 2024

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d), nenit 17, shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6, paragrafi 1, pika 1.1 dhe nenit 8, paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5, paragrafi 1, pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.09.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës - lokaleve afariste te Stacioni i Autobusëve në Rahovec, të cilët janë të ndërtuara në parcelën Nr.- 71510057-01789-2, në vendin e quajtur Ispod Sela në posedim të Komuna e Rahovecit, me të drejtë të shfrytëzimit në kohë të pacaktuar nga ndërmarrja publike lokale Stacioni i autobusëve Rahovec SH.A., dhe jepen në shfrytëzim lokalet afariste personave fizikë dhe juridikë përmes zhvillimit të procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër deri në 10 (dhjetë) vjet.
2. Pronat e paluajtshme – lokalet afariste për dhënien në shfrytëzim, të cekura në pikën 1 të këtij propozimi janë:
 - 2.1. Lokali afarist sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-180-4-1-0 në, në sipërfaqe të përgjithshme prej 45.85m² (dyzet e pesë pikë tetëdhjetë e pesë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
 - 2.2. Lokali afarist sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-180-3-1-0 në, në sipërfaqe të përgjithshme prej 45.39m² (dyzet e pesë pikë tridhjetë e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
 - 2.3. Lokali afarist sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-180-2-1-0 në, në sipërfaqe të përgjithshme prej 43.40m² (dyzet e tre pikë dyzet metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
 - 2.4. Lokali afarist sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-180-1-1-0 në, në sipërfaqe të përgjithshme prej 45.73m² (dyzet e pesë pikë shtatëdhjetë e tre metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
 - 2.5. Lokali afarist sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-180-5-1-0 në, në sipërfaqe të përgjithshme prej 37.79 m² (tridhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
 - 2.6. Lokali afarist sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-180-5-2-0 në, në sipërfaqe të përgjithshme prej 37.17m² (tridhjetë e shtatë pikë shtatëmbëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

- 2.7. Lokali afarist sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-180-5-3-0 në, në sipërfaqe të përgjithshme prej 35.87m² (tridhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e shtatë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
- 2.8. Lokali afarist sipas certifikatës së pronësisë Nr.0-71510057-180-5-4-0 në, në sipërfaqe të përgjithshme prej 50.26m² (pesëdhjetë pikë njëzet e gjashtë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale.
 4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 10 (dhjetë) vjet.
 5. Realizimi i pagesës në qira fillon 3 muaj pas nënshkrimit të kontratës.
 6. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kurdoherë që, sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës, ta ndryshojë kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.
 7. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
 8. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020. për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.**
 9. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, të zhvillojë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
 10. Obligohet Kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
 11. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
 12. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në faqen ueb të Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.253/24
Me datë:24.09.2024

